



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:061972

Datë: 30.09.2020

Numri i dokumentit: 01152493

**P.nr.1010/20**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,** gjyqtarja e vetme gjykuese Sulltane Hoti, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Flamur Pireva, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.B., për shkak të veprës penale, Dhuna në Familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamentit i Përgjithshëm PP/II.nr.1227/2020, të datës 08.05.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar, me datë 28.09.2020, në praninë e Prokurores së shtetit Edina Jupolli dhe të akuzuarit A.B., në bazë të nenit 366 të KPPRK-së, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht në prezencën e palëve shpalli, ndërsa me datë 29.09.2020 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**A.B.**, nga i ati H., dhe nënës S., e gjinisë S., i lindur me *data e lindjes...*, në P., me vendbanim në F., afër V., rr. "...", Objekti C., kati 6, nr.42, me numër personal *numri personal...*, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB-ja, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, realizon pension të veteraneve të luftës, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### Sepse:

Me datën 25.03.2020, rreth orës 23:30, në rrugën "N...", F., në shtëpinë e tyre familjare, i pandehuri për shkak të mosmarrëveshjeve me të dëmtuarën-bashkëshorten e tij, tani të dëmtuarën A.B., i njëjti ka ushtruar dhunë fizike ndaj të dëmtuarës me qëllim të cenimit të dinjitetit të saj, në atë mënyrë, pasi që kishte lexuar një mesazh në telefonin e të dëmtuarës nga një person, për të i panjohur, ka përdorur forcën fizike duke e goditur të dëmtuarën me grusht në fytyrë dhe në anën e djathtë të shpinës, dhe si pasojë e këtyre veprimeve, të njëjtës i'a ka shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë për jetë,

**-me këtë ka kryer veprën penale, Dhuna në Familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4; 7; 17; 20; 21; 38; 39; 43; 46 par.1 nënpar.1.1; 47; 48; 49; 69; 70; 71 dhe 72 të KPRK-së dhe neneve 248, 359, 365 dhe 366 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

- Ashtu që i vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, dhe

### **DËNIM ME GJOBË**

Në shumë prej **300€ (treqind Euro)**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi,

- Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurës penale aq sa do të llogariten sipas shpenzimoreve përfundimtare të gjykatës, ashtu që në emër të ekspertizës mjekoligjore shumë prej njëzet euro (20 €), në emër të kompensimit për viktimat e krimit të paguaj shumë prej tridhjetë euro (30€), ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej tridhjetë euro (30 €), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- E dëmtuara: A.B., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.1227/2020, të datës 08.05.2020, ka akuzuar A.B., për shkak të veprës penale, Dhuna në Familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.09.2020, ku prezantuan Prokurorja e shtetit, Edina Jupolli, dhe i akuzuari A.B.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit iu dha mundësia e deklaramit të tij lidhur me fajësinë i cili deklaroi, se e ndien vetën fajtor për veprën penale, të cilin pranim e bëri me vullnet dhe pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, duke i ditur pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, duke shtuar se ngjarja ka ndodhur në afekt, në atë çast kam qenë i nervozuar, ndihet i penduar, edhe në polici ka deklaruar që është penduar, tani më të dëmtuarën jetojnë bashkë dhe janë pajtuar, dhe në fund e luti gjykatën që t'i më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Prokurorja e shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, të cilin pranim e bëri në përputhshmëri me të gjitha pikat e akuzës që i vihen në barrë dhe i vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e pranimit të fajësisë, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion e në përputhje të plotë edhe me provat të cilat i janë bashkangjitur akuzës dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 të KPRK-së, dhe i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe në fund i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari, gjykata konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, Gjykata nuk administroj prova por vlerësoj se në veprimet e të akuzuarit, formësohen të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, Dhuna në Familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.2 të KPRK-së, e të cilën i akuzuari e ka kryer me dashje.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë, pendimin e tij për veprën e kryer penale, premtimin se nuk do të përsërisë apo nuk do të kryejë ndonjë vepër penale, sinqeritetin e tij deklarues, me të dëmtuarën janë pajtuar dhe jetojnë bashkë, gjendjen ekonomike, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin me kusht dhe dënimin me gjobë në shumë prej 300 Euro, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se këto dënime janë adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenin 69 par.2 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së dhe qëllimi i dënimit me kusht e që është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 47 të KPRK-së.

Dënimi i shqiptuar me kusht, është risocializim i të akuzuarit me anë të pezullimit të dënimit. Me anë të këtij dënimi kryesit iu tërhiqet vërejtja seriozisht dhe u bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale dënimi i suspenduar për një kohë të caktuar do të ekzekutohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.05/L-036.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr.1010/20, datë 29.09.2020.**

**Zyrtar ligjor,  
Flamur Pireva**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese  
Sulltane Hoti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.